



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 11.07.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË NDRYSHIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DUKE VEPRUAR NËPËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE DHE TRANS ADRIATIC PIPELINE AG, LIDHUR ME MARRËVESHJEN ME QEVERINË E VENDIT PRITËS”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline ag, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”, në mbledhjen e datës 11 Korrik 2018.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës, e cila është ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr.116/2013.

Ndryshimet e propozuara synojnë të përfshijë në marrëveshjen me qeverinë pritëse disa dispozita që rregullojnë trajtimin e tatimit mbi vlerën e shtuar në lidhje me aktivitetet e ndërtimit gjatë fazës së ndërtimit të projektit TAP, kryesisht për të përfshirë zbatimin e skemës së autofaturimit në lidhje me TVSH-në e investitorit të projektit dhe kontraktorëve për sa i përket furnizimit të mallrave dhe shërbimeve.

Ky propozim i ri në skemën e TVSH-së, në lidhje me projektin TAP, është kombinim i sistemit të autofaturimit (*reverse-charge*) dhe sistemit tradicional të aplikimit të TVSH-së, që synon të ulë në parametra të menaxhueshëm shumën e kërkesave për rimbursime të TVSH-së, me qëllim që projekti TAP të mos vihet në vështirësi për financimin e punimeve.

Rishikimi i skemës së TVSH-së dhe kalimi në skemën e re të propozuar vlerësohet se është i nevojshëm duke marrë në konsideratë jo vetëm rimbursimin e përshpejtuar të TVSH-së për kërkesat e paraqitura tashmë nga projekti TAP, por dhe fluksin në rritje të tyre që pritet të vijojë në vitet 2018 e 2019.

Sipas skemës së re të propozuar, sistemi i autofaturimit nënkupton që detyrimi për llogaritjen dhe pagesën e çdo detyrimi TVSH-je autoriteteve tatimore, për të gjitha furnizimet e nevojshme të lidhura me projektin TAP, gjatë fazës së ndërtimit, do të bjerë mbi përfituesin e furnizimit dhe jo mbi furnizuesin e mallit. Ky kalim i përgjegjësisë për të llogaritur dhe paguar TVSH-në nga furnizuesi te përfituesi i furnizimit quhet mekanizmi i *reverse-charge*.

Kjo skeme specifike do të aplikohet për kontraktorët e nivelit të parë dhe të dytë, të cilët do t'i komunikohen Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ndërsa nga niveli 3 i kontraktorëve e në vazhdim, parashikohet aplikimi i sistemit tradicional të TVSH-së.

Importet e kryera nga investitori i projektit ose çdo kontraktor i nivelit 1 gjatë fazës së ndërtimit, për furnizimet e mallrave që lidhen me projektin janë të përjashtuara nga TVSH-ja. Ato trajtohen si furnizime mallrash të kryera nga importuesi për veten e tij, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike. Për sa u përket furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve brenda vendit nga një kontraktor i nivelit të parë ose i nivelit të dytë, vetëm përfituesi i mallrave/shërbimeve do të jetë i detyruar të paguajë TVSH-në dhe ka të drejtën e zbritjes së kësaj TVSH-je sipas rregullave të përcaktuara.

Aplikimi i mekanizmit të *reverse-charge* parashikohet nga direktiva e BE-së nr.2006/112/EC “Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar”, në nenet 194 deri 199 të saj si përjashtim ndaj rregullit kryesor që TVSH-ja është e pagueshme nga personi që kryen furnizimin. Gjithashtu, ky mekanizëm është i njohur për autoritetet shqiptare, pasi është përdorur në kuadër të legjislacionit fiskal.

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Zbatimi i projektligjit nuk shoqërohet me shpenzime financiare në buxhetin e shtetit.

Diskutimet në komision u përqendruan në çështje të zbatimit të sistemit të *autofaturimit*, të cilat lidhen me: eksperiencën e administratës tatimore për administrimin e këtij sistemi; shkallën e reflektimit të lehtësive administrative të pretenduara; efektet në buxhetin e shtetit etj.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicë votash, u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Një deputet abstenoj, ndërsa deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm.

RELATORE

KRYETAR

Tatjana PIRO

Eduard SHALSI